



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Primljeno Më/Dana 24-11-2014

Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vrednost
01-013/1682			



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Bazuar në nenin 51 pika 1) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta zyrtare nr 2008/28 dhe nenit 41 pika 1 nën a) të Statutit të Komunës së Vitisë nr 01 - 013/491 të datës 21.04.2011 Kuvendi i Komunës së Vitisë në seancën e mbajtur më 13 nëntor 2014 shqyrtoi propozim vendimin për rishqyrtimin e Vendimit për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe aprovoi këtë:

V E N D I M
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT PËR FORMIMIN E
KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

I.

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Vitisë Aprovoi ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa nr. 01-013/169 të datës 11.02.2014.
Kuvendi i Komunës së Vitisë APROVOI propozimin që subjekti politik NISMA të këtë një anëtar në Komitetin për Politikë dhe Financa të Kuvendit të Komunës së Vitisë.

II.

Komiteti për Politikë dhe Financa ka 7 anëtar dhe ka këtë përbërje:

1. Naim Pira - (LDK)- Kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Ali Bajrami - (LDK) -anëtar,
3. Sami Demelezi -(LDK) – anëtar,
4. Bekim Azizi -(PDK)- anëtar,
5. Mirlinda Sadiku- (AAK) - anëtar
6. Baki Nebiu- (VV)-anëtar dhe
7. Daut Xhemajli -(NISMA) - anëtar,

III.

Detyrat e Komitetit për Politikë dhe Financa janë të përcaktuara në nenin 52 paragrafi 2 të Ligjit për vetëqeverisjen Lokale Nr 03/L-040 dhe nenit 43.1 të Statutit të Komunës së Vitisë.

IV.

Ditën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet Vendimi për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa nr 01-013/169 i datës 11.02.2014.

V.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Vendimi u dërgohet:

1. Kryesuesit të Kuvendit
2. Anëtarëve të KPF-së
3. Arkivit

KRYESUESI I KUVENDIT

